



Muaji Ramazan – Konfirmimi i hyrjes së muajit të Ramazanit

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد .أما بعد

■ GJYKIMI I ANGAZHIMIT PËR TË PARË HËNËN E RAMAZANIT

Sa i përket gjykimit të angazhimit për të parë hënën e Ramazanit ka mospajtim.

Një pjesë e dijetarëve thonë se është e pëlqyer që njerëzit të dalin (të angazhohen) për të parë hënën e Ramazanit.

Ibn Kudameh - prej dijetarëve Hanbeli (All-llahu e mëshiroftë) thotë:

"يستحب للناس تراءى الهلال ليلة الثلاثين من شعبان"

"Pëlqehet që njerëzit të angazhohen (të dalin, të kujdesen) për të parë hënën e Ramazanit në natën e tridhjetë të Sha'banit."

Ibn Uthejmini (All-llahu e mëshiroftë) thotë:

فالسنة للناس أن يترأوا هلال رمضان ليلة الثلاثين من شعبان.

"Prej sunnetit është që njerëzit të angazhohen për të parë hënën e Ramazanit në natën e tridhjetë të Sha'banit."

[Audio. ما حكم رؤية الهلال و هل يكفي لثبوته شهادة رجل واحد. Youtube]

Hanefitë thonë: "Është detyrë Kifaje - Dmth: është detyrë për disa njerëz, jo për të gjithë."

[E përmend këtë Ibn Nuxhejm - prej dijetarëve të mëdhenj hanefi në librin (El Behr Er-Raik 2/284)]

Imam Neueuiju (All-llahu e mëshiroftë) në shpjegimin e fjalës së Profetit alejhis-salam ((Agjëroni kur t'a shihni hënën)) thotë:

المراد: رؤية بعض المسلمين و لا يشترط رؤية كل إنسان.

"Qëllimi këtu është: shikimi (i hënës) nga ana e disa muslimanëve (dmth: prej një pjese kërkohet t'a shikojnë hënën), dhe nuk është kusht që çdo njeri t'a shikojë atë."

[Sherh Sahih Muslim 7/190]

Lexhnja (Komisioni i Përhershëm) thotë:

أما الاستدلال بحديث ((صوموا لرؤيته (...على أن كل فرد لا يصوم إلا برؤيته بنفسه فغير صحيح؛ لأن الحديث خطاب عام بالصيام عند تحقق الرؤية و لو من واحد عدل من المسلمين

"Sa i përket argumentimit (të disave) me hadithin ((Agjëroni kur të shihni hënën...)), se është detyrë për çdo person të agjëroje atëherë kur t'a shohë secili vet, është argumentim jo i vërtetë (jo i saktë).

Sepse hadithi i drejtohet të gjithëve që të agjërojnë, kur të vërtetohet (konfirmohet) shikimi i hënës, (dhe kjo) qoftë edhe prej një personi të besueshëm (ADL)."

[Fetawa El-Lexhne Ed-Deimeh, 10/94]

Pra, hadithi nuk tregon se duhet çdokush t'a shohë hënën.

Hadithi tregon se është detyrë për të gjithë të fillojnë agjërimin, kur të vërtetohet shikimi i hënës.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka pranuar dëshminë e një personi për konfirmimin e hënës.

Ibn Umeri radijall-llahu anhumu thotë:

تراءى الناس الهلال، فأخبرت رسول الله ﷺ أني رأيته، فصام وأمر الناس بصيامه.

((Njerëzit po vëzhgonin hënën (e Ramazanit). Unë e njoftova të Dërguarin e Allahut alejhis-salam se e pashë atë. Atëherë ai agjëroi dhe i urdhëroi njerëzit të agjëronin))

[Ebu Dawudi / Albani thotë Hadith Sahih (Sahih Ebi Dawud)]

Ky hadith është argument që tregon qartë se nuk është obligim t'a shohë çdo individ, por mjafton dikush i besueshëm.

Nëse do ishte obligim për të gjithë, do ishte e pamundur për shumicën dërrmuese të njerëzve, dhe si rezultat do ishin mëkatar në lidhje me këtë çështje shumica e njerëzve. Por këtë nuk e thotë kush prej dijetarëve.

Pra, nuk kërkohet prej të gjithëve të shohin hënën, por prej një grupi (pjesë) njerëzish.

A është detyrë për një pjesë, apo jo?

Hanefitë thonë po.

Hanbelitë thonë është e pëlqyer.

Malikitë dhe Shafiitë, nuk di ndonjë fjalë prej tyre në lidhje me këtë.

Unë anoj te ajo se duhet që një pjesë të angazhohen për shikimin e hënës, dhe mendimin e atyre që e obligojnë për një pjesë, e shoh mendim të fortë.

All-llahu e di më së miri.

Ai është më i Dijshmi.

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه وسلم